



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.529/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për Kuvend Komunal në Deçan, Antoneta Hulaj, nga radhët e subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, për shkak të parregullsive në vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e Antoneta Hulaj, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Deçan me shenjen ZL.Anr.529/2017 e datës 26.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan, për shkak të parregullsive në vendvotim.

A r s y e t i m

Më datën 26.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Antoneta Hulaj, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Deçan, me të cilën ka pretenduar se ka pasur parregullsi në qendrat votuese në Deçan, 10101x, 0101c,0102c, 0114, 501 08 c, në Carrabreg, Shkolla e mesme (Deçan), Fshati Drenoc, Strellci i ulët, Isniq. Kërkon nga Paneli të bëhet verifikimi dhe kontrollimi në këto qendra të votimit.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkuar asnjë provë lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga Antoneta Hulaj, kandidate për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Deçan është e parregullt sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesja e ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kushtet si kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015, të PZAP-it dhe në bazë të nenit 118 të

LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshteje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.529/2017 më datën 26.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*